



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti-na

Në bazë të Rregullores për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Vitisë Nr. 01-013/246, neni 3, 6, 8, 9 dhe neni 10, si dhe buxhetit të planifikuar dhe të paraparë për këtë destinim, Drejtoria për Arsim e Komunës së Vitisë, shpall:

KONKURS PUBLIK

Për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Vitisë, për vitin akademik 2018/19

Drejtoria për Arsim e Komunës së Vitisë, shpall konkurs publik për ndarjen e **133** bursave, në vlerë **300 €**, për vitin akademik 2018/19. Bursat ndahen për studentë të fakulteteve/lëmenjtë deficitarë, për student të familjeve përfitues të ndihmës sociale, student të familjeve të dëshmorëve të luftës, invalid të luftës dhe veteran të luftës si dhe studentë të familjeve pa prind në jetë.

Kriteret për aplikim:

- Të jenë studentë të Komunës së Vitisë;
- Të jenë studentë të rregullt në Universitetin Publik të Republikës së Kosovës;
- Të jenë studentë të fakultetit/lëmenjtë deficitarë.

Në kushte të barabarta, përparësi në përfitimin e bursës kanë:

- Studentët me asistencë sociale;
- Studentët e veteranëve të luftës;
- Studentët e familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës;
- Studentët e gjinisë femërore.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Për studentët fillestar, diploma e shkollës së mesme, indeksin e fakultetit fotokopje;
- Studentët të cilët kanë përfunduar ndonjë vit akademik të sjellin çertifikatën e notave (indeksin fotokopje);
- Studentët të cilët janë përfitues i bursës nga fakulteti, nuk përfitojnë bursë komunale.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Viti.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, ndërsa dokumentet e pakompletuara nuk merren në shqyrtim.

Viti, më 02.10.2018

Drejtoria për Arsim-Viti